

Marrëdhëniet Shqiptaro-Serbe dhe Konflikti mbi Statusin

Këshilli për Qeverisje Gjithpërfshirëse (CIG) organizoi një grup fokusi në Prishtinë më 20 qershor 2018. Grupi i fokusit përfshiu studentë dhe anëtarë të organizatave të shoqërisë civile nga Kosova. Përfshiu shtatë grupe pyetjesh, duke filluar nga komunikimet ndëretnike deri tek konflikti mbi statusin ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Ky raport përfshinë pikat kyçe të diskutimit.¹

Tryeza e rrumbullakët është pjesë e projektit të CIG-së lidhur me normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, mbështetur nga dhe implementuar në bashkëpunim me Departamentin Zvicerran për Punë të Jashtme.

1. Marrëdhëniet me serbë

- Shumica e pjesëmarrësve kanë pasur komunikim me serbë të Kosovës dhe serbë nga Serbia në kontekst profesional. Shumë raportuan që komunikimet me serbë janë duke u bërë normale çdoherë e më shumë. Shumë pjesëmarrës kanë qenë në Serbi për aktivitete profesionale dhe raportuan bashkëpunime shoqërore me serbët atje.
- Ata kanë qenë pjesë e punëtorive të ndryshme dhe tryezave me fokus në çështje shoqërore, por që edhe temat politike gjithashtu kanë qenë pjesë e diskutimeve, duke përfshirë integrimin e veriut të Kosovës dhe dialogun e Brukselit.
- Politika ka ndikim në marrëdhëniet në mes të rinjëve në Serbi dhe Kosovë. Disa raportuan që gjatë një vizite të përbashkët në Bruksel, grupi serb ka refuzuar të jetë pjesë e vizitës në ambasadën e Kosovës në Bruksel. Pjesëmarrësit shqiptarë dhe serbë në ngjarjet në Bruksel gjithashtu kanë qenë të ndarë në shumë çështje politike, duke pasqyruar politikat e vendit të tyre.
- Shumë thanë që komunikimet dhe bashkëveprimet në mes të rinisë në Kosovë dhe Serbi nuk janë të mjaftueshme, dhe që numri i aktiviteteve të përbashkëta është i kufizuar.
- Bashkëveprimet treguan që rinia në Kosovë dhe Serbi ndajnë më shumë çështje sesa që zakonisht besohet. Një numër i pjesëmarrësve thanë që rinia nga të dy vendet janë viktimë e politikës.

¹ Në mars 2018, CIG-u ka organizuar një event të ngjajshëm në Beograd. Raporti i fokus grupit të Beogradit është në dispozicion në <http://www.cigonline.net/ep-content/uploads/2018/03/Serb-Albanian-Relations-and-Kosovo-Status-Dispute-Focus-Group-1.pdf>.

- Në integrimin e veriut të Kosovës, pjesëmarrësit ishin të ndarë: disa thanë që veriu reziston integrimin në Kosovë përderisa të tjerët thanë që Kosova duhet fajësuar gjithashtu për mos ofrimin e mundësive të mjaftueshme për të ndihmuar integrimin.
- E kaluara mbetet pengesë për komunikim dhe bashkëpunim më të mirë. Disa prej pjesëmarrësve vetë kishin përjetuar luftën dhe komunikimi me serbë menjëher pas luftës kishte qenë “traumatik”. Shumë thanë që shoqëritë serbe dhe shqiptare ia vënë fajin njëra tjetrës, por “fakti është se jo të gjithë kanë qenë të përfshirë në krime”.
- Marrëdhëniet e ndara në para dhe pas-luftës, dhe lufta mbesin pengesa më e madhe drejt ndërtimit të marrëdhënieve dhe besimit. Lufta është duke u manipuluar nga elitat politike për interesat e tyre. Shumë pak serbë në Serbi janë të vetëdijshëm për krimet e kryera gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë.
- Dialogu i Brukselit i ka përmirësuar marrëdhëniet deri diku dhe ka zgjidhur disa çështje, siq janë dokumentet e udhëtimit, por ka pasur pak ndikim në normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shoqërive.

2. E kaluara, interpretimet dhe dialogu

- Kosova dhe Serbia kanë pasur një të kaluar të vështirë, më së shumti të dominuar nga armiqësitë, por edhe kur një nivel i bashkëjetesës ka ekzistuar në Jugosllavi nuk ka qenë tërësisht vullnetar. Sistemi shtynte serbët dhe shqiptarët të punonin së bashku. Shoqëritë shqiptare dhe serbe nuk kanë një pikë të mirë referuese për të kaluarën. Edhe gjatë komunizmit në Jugosllavi kur marrëdhëniet në mes të dy shoqërive dukeshin të mira në sipërfaqe, edhe shqiptarët edhe serbët mbanin mëri ndaj njëri tjetrit.
- Politikanët, si ata Kosovarë edhe ata Serbë, janë të përfshirë në manipulimin e të kaluarës për interesat e tyre personale dhe politike.
- Shoqëritë shqiptare dhe serbe nuk duan t’ a pranojnë pjesën e tyre të përgjegjësive për armiqësitë e së kaluarës. Shumë thanë që Serbia ka kryer shumicën e krimeve, por që disa shqiptarë, të organizuar apo jo, gjithashtu kanë kryer krime e veçanërisht pas luftës. Është në interesin e komuniteteve shqiptare dhe serbe t’i “pastrojnë” shoqëritë e tyre nga elementet e krimit.
- Urrejtja etnike është më e theksuar në zonat rurale si në Kosovë ashtu edhe Serbi. Sidoqoftë, shumë thanë që urrejtja dhe nacionalizmi janë gradualisht duke rënë. Njerëzit janë më të preokupuar me gjetjen e një punë dhe përmirësimin e situatës së tyre ekonomike sesa me “përmirësimin e çështjeve nacionale”.
- Librat shkollorë të mbushur me urrejtje etnike dhe ekzagjerim të krimeve të anës tjetër janë një pengesë e madhe për pajtim dhe ndërtim të marrëdhënieve normale, veçanërisht në mes të rinisë së të dy vendeve. Shumë të rinjë nuk kanë pasur bashkëveprim dhe komunikim me anën tjetër dhe njoftimi i tyre i vetëm me anën tjetër është nëpërmjet librave shkollorë. Librat shkollorë të tillë janë duke krijuar zbrazëtira të mëdha në normalizimin e marrëdhënieve që do të nevojiteshin vite për përmirësim.

3. Pajtimi

- Procesi i pajtimi në mes të shoqërive serbe dhe shqiptare mbetet i komplikuar dhe asnjëra nga shoqëritë nuk dëshiron të adresojë të kaluarën nëpërmjet një debati jo-emocional dhe realist. Diskutimi lidhur me pajtimin dominohet nga liderë qeveritarë

dhe të partive politike që duket se nuk kanë ndonjë interes në përmirësimin e procesit.

- Procesi duhet të udhëhiqet nga jo-politikanët dhe të fokusohet në eksperiencat që anëtarë të të dy shoqërive kanë pasur. Pajtimi nëpërmjet adresimeve për konfliktet politike vetëm sa komplikon procesin.
- Shoqëria civile heziton të adresojë çështjet që vërtetë i preokupojnë të dy shoqëritë. Ata organizojnë shumë debate por shmangin çështjet e ndjeshme, veçanërisht në publik. Nevojiten më shumë debate publike lidhur me luftën, krimet, përgjegjësinë dhe drejtësinë, në mënyrë që qytetarët të besojnë se pajtimi është i mundshëm.
- Sundimi i ligjit është komponenta kryesore për procesin e pajtimit. Autorët e krimeve duhet të dalin para drejtësisë për krimet e kryera. Ata të cilët kanë vuajtur gjatë luftës nuk mund të pajtohen me autorët e krimit. Shoqëritë duhet të jenë më të gatshme për të denoncuar krimet dhe të mbështesin institucionet për të arritur rezultate në zbardhjen e fatit për krimet e mëdha në luftë. Të dy shoqëritë ende i trajtojnë të dyshuarit e luftës si heronjë.
- Paragjykimet ende janë të forta nga të dy anët.
- Janë dy procese të pajtimit: njëri ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe tjetri ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë. Kosova duhet fillimisht të fillojë procesin e pajtimit me serbët e Kosovës në përpjekje për t'i bërë ata të ndjehen pjesë e shoqërisë Kosovare dhe strukturës institucionale. Edhe serbët e Kosovës gjithashtu nuk duhet të stepen nga denoncimi i krimeve që janë kryer nga serbët e Kosovës.

4. Sfidat për normalizimin e marrëdhënieve shoqërore

- Paragjykimet, e kaluara dhe mungesa e sundimit të ligjit mbesin sfidat kryesore në ndërtimin e marrëdhënieve më të mira në mes të të dy shoqërive.
- Elitat politike të dala nga koha e luftës shihen si të dyshuar nga të dy shoqëritë. Jo vetëm që nuk e gëzojnë besimin nga pala tjetër, por në të shumtën e rasteve nuk e gëzojnë besimin as nga popullata e tyre. Shumë konsideruan që institucionet në Kosovë dhe Serbi nuk janë mjaft demokratike edhe pse janë të përzgjedhur nëpërmjet “zgjedhjeve të lira”. Udhëheqësit ndonjëher bëjnë disa hapa pozitiv drejt normalizimit, siq janë marrëveshjet e Brukselit, por shpesh ata vetë krijojnë incidente që dërgojnë normalizimin mbrapa në pikën e fillimit.
- Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë dhe Serbi mund të bëjnë më shumë në krijimin e një komunikimi real dhe bashkëveprim ndërmjet të dy shoqërive.
- Komuniteti ndërkombëtar mund të jetë më shumë i angazhuar në shtyrjen e palëve drejt normalizimit duke iu ndihmuar në implementimin e marrëveshjeve të Brukselit.

5. Normalizimi gjithpërfshirës

- Kosova është e gatshme për normalizim por vetëm nëse Serbia pajtohet ta njoh Kosovën. Shumë pak Kosovarë besojnë që normalizimi i plotë është i mundshëm pa njohje. “Ne nuk mund të jemi miq me dikë që merr shtëpinë tonë”.
- Normalizimi është duke ndodhur vetëm në mes të qeverive, por jo edhe në mes të shoqërive. Shumë thanë që është shumë e mundshme që shoqëritë do të mbesin të barrikaduara në pozicionet aktuale, duke refuzuar të marrin hapa të mëdhenjë drejtë normalizimit shoqëror.

- Marrëveshja e Brukselit ka krijuar disa mundësi në normalizimin politik por që tensionet e ndërlidhura me implementimin iu kanosen progresit.
- Normalizimi varet nga një grup i vogël njerëzish në Kosovë dhe Serbi. Në Kosovë janë rreth pesë njerëz të cilët do të vendosin për ecurinë e procesit, përderisa në Serbi është vetëm një person i tillë. Prandaj procesi mund të shkojë në çfardo kahje: avansim të normalizimit ose kalim drejt një konflikti të ri.
- Shoqëritë Kosovare dhe Serbe nuk janë “normale” as për së brendshmi në shumë aspekte: ekonomi të dobëta, mirëqenie sociale jo-adekuate, dallimi në rritje në mes të të pasurve dhe të varfërve, korrupsion dhe krim i organizuar.

6. Opcionet për statusin

- Është duke u bërë gjithnjë e më hutuese se si do të duket marrëveshja finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja duhet të bazohet në vlera të BE-së dhe të ketë parasysh interesin e popullatës.
- Ndarja duhet të mos jetë në tavolinë. Ka shumë gjasë që do të krijonte kaos në Kosovë, të destabilizojë vendin, duke krijuar përplasje ndëretnike dhe dobësojë pozitën e Kosovës në skenën ndërkombëtare. Shumë politikanë në Kosovë dhe Serbi janë të interesuar të krijojnë kaos me qëllimin e prolongimit të qëndrimit të tyre në pushtet, veçanërisht kur situata ekonomike po përkeqësohet.
- Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe duhet të formohet në përputhje me kushtetutën e Kosovës. Gati të gjithë pjesëmarrësit ishin kundër ndryshimeve kushtetuse dhe ligjore për ti ofruar më shumë fuqi Asociacionit/Komunitetit.
- Njohja eksplicite e Kosovës nga Serbia është opcioni më i mirë.
- Status kuo-ja dhe vazhdimi i dialogut të Brukselit nuk është e qëndrueshme. Sidoqoftë, status kuo-ja në dekadën e ardhshme është opcioni më i mundshëm.